

## **Raport individual për rezultatin e konsultimit publik për Projektligjin “Për Treguesit Gjeografikë dhe Emërtimet e Origjinës”**

### **1. Titulli i projektligjit “Për Treguesit Gjeografikë dhe Emërtimet e Origjinës”**

### **2. Kohëzgjatja e konsultimeve**

Procesi i konsultimit filloi me publikimin në RENJK të njoftimit paraprak sipas legjislacionit në fuqi për njoftimin dhe konsultimin publik në periudhën dt 19.01.2026. deri në datë 16.02.2026.

### **3. Metoda e konsultimit**

Metodat e konsultimit të përdorura për Projektligjin “Për Treguesit Gjeografikë dhe Emërtimet e Origjinës”, janë si më poshtë vijon:

- **Takime me grupet e interesit:** janë zhvilluar takime në nivel teknik me përfaqësues të autorizuar
  
- **Publikimi në Regjistrin Elektronik për Njoftimet dhe Konsultimet Publike** në linkun <https://konsultimipublik.gov.al/Konsultime/Detaje/923>

### **4. Palët e interesit të përfshira**

Drejtoria e Përgjithshme e Pronësisë Industriale ka kryer konsultimin e brendshëm për këtë projektligj me përfaqësuesit e autorizuar dhe me organizatat ndërkombëtare, konkretisht me Organizatën Botërore të Pronësisë Intelektuale (WIPO), Zyra e Bashkimit Evropian për Pronësinë Intelektuale (EUIPO).

Zyra është pajtuar me të gjitha ndryshimet e propozuara nga WIPO dhe EUIPO dhe i pranojmë siç duhet.

Gjatë Konsultimit Publik dhe takimit me përfaqësuesit e autorizuar nuk ka patur komente.

### **5. Pasqyra e komenteve të pranuar me arsyetimin e komenteve të pranuar/ refuzuara**

<b>Çështja e adresuar</b>	<b>Komenti</b>	<b>Palët e interesuara</b>	<b>Vendimi</b>	<b>Justifikimi</b>

Në tërësi të projektligjit, komente teknike	Përshtatje e terminologjisë.	<b>KE</b>	Pranuar	
Heqja e paragrafit	“Mbajtës i së drejtave” është subjekti ose grupi i prodhuesve që vepron në zonën gjeografike përkatëse dhe që, sipas këtij ligji, ka të drejtë të përdorë dhe të mbrojë treguesin gjeografik ose emërtimin e origjinës.	<b>EUIPO</b>	Pranuar	
Përshtatje e terminologjisë.	Term gjenerik: është bërë një fjalë e zakonshme në Republikën e Shqipërisë që është përshkruar për tipin e produktit ose për cilësitë e produktit; ose është një fjalë që nuk i referohet ndonjë produkti specifik	<b>EUIPO</b>	Pranuar	
Përshtatje e terminologjisë, ndryshuar	Ndryshimi i vendeve të nënve 17 dhe 18 u bë sipas sugjerimit të konsulentit të BE-se.	<b>KE</b>	Pranuar	
Përshtatje e terminologjisë, ndryshuar	Treguesit Gjeografikë Për Produkte Artizanale Dhe Industriale	<b>EUIPO</b>	Pranuar	

<p>Përshtatje e terminologjisë, ndryshuar</p>	<p>Përkufizimi dhe përdorimi përgjatë tekstit të termit "mbajtës i të drejtave" / "mbajtës i të drejtave" jep përshtypjen e pronësisë individuale, gjë që është problematike në kontekstin e BE-së, pasi treguesit gjeografikë janë një e drejtë kolektive publike. Për këtë arsye, legjislacioni i BE-së shmang referencat për "mbajtësit e të drejtave" ose shprehje të ngjashme që sugjerojnë pronësi mbi IG-në. Përcaktimi i IG-ve në terma të pronësisë mund të nënkuptojë gabimisht se përdorimi i emrit IG është i kufizuar për anëtarët e një entiteti ose grupi të caktuar dhe nuk është i hapur për prodhues të tjerë edhe nëse ata përputhen gjithashtu me specifikimet përkatëse të produktit. Kjo nuk është në përputhje me sistemin IG të BE-së.</p>	<p><b>EUIPO</b></p>	<p>Pranuar</p>	
<p>Ndryshuar</p>	<p>Përfshirimi i Pjesës II, Kapitullit V — i titulluar “Emërtimet e Originës dhe Treguesit Gjeografikë për Produktet</p>	<p><b>EUIPO</b></p>	<p>Pranuar</p>	

	Bujqësore” — duket i paqëndrueshëm, dhe teksti gjithashtu lë jashtë çdo referencë për CIGI-të.			
--	--	--	--	--